



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 44

Prishtinë, më 15.3.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Sergjan Popoviç, Shpejtim Bulliqi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Shinik.

Munguan: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: ministri i MASHT, Arsim Bajrami, përfaqësues nga MASHT, KDI, KYC dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.3.2016;
3. Raportimi i ministrit lidhur me pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, shpërndarjen, përdorimin dhe ruajtjen e tyre;
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.3.2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 4.3.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i ministrit lidhur me pajisjen e nxënësve me tekste shkollore falas, shpërndarjen, përdorimin dhe ruajtjen e tyre

Nait Hasani, kryetar, tha se Komisioni ka vendosur të ftojë ministrin, me qëllim që të raportojë lidhur me pajisjen e nxënësve me tekstet shkollore, si dhe të njoftohet lidhur me çështjen e kthimit të teksteve shkollore, të destinuara për Luginën e Preshevës.

Ministri Arsim Bajrami, raportoi para anëtarëve të Komisionit lidhur me tekstet shkollore, shpërndarjen, përdorimin dhe ruajtjen e tyre. Ai tha se sipas Ligjit për Arsimin parauniversitar, neni 26, pika 4, tekstet shkollore përgatiten dhe shpërndahen falas, për të gjithë nxënësit nga klasa e arsimit të obliguar, pra nga klasa e parë, deri në klasë të nëntë.

Me Udhëzimin Administrativ nr.16/2012, përcaktohet mënyra dhe procedurat e shpërndarjes së teksteve shkollore, si dhe përgjegjësitë e nxënësve dhe të prindërve.

Ministri e informoi Komisionin se Ministria ka aktivizuar Këshillin për tekste shkollore, që do të merret me çështjen e rishikimit të teksteve mësimore dhe vlerësimin e tyre. Lidhur me këtë, Këshilli për vlerësim ka përcaktuar 13 standarde të rishikimit dhe vlerësimit të teksteve shkollore, duke filluar nga përdorimi i gjuhës, konteksti gramatikor, më pas fjalët që mund të përmbajnë gjuhë të urrejtjes apo diskriminuese, aspektet e kurrikulës, si dhe aspekte tjera pedagogjike. Ministria ka hasur vërejtje në tekstet e historisë, gjeografisë, gjuhës shqipe, si dhe në librin e edukatës qytetare. Tekstet e historisë do të rishikohen, duke përfshirë në njësitë mësimore faktet reale të pasqyrit të ngjarjeve, në mënyrë që nxënësit të kenë para vetes një pasqyrim real të gjendjes që ka ndodhur. Në tekstet e gjeografisë do të rishikohen hartat dhe do të bëhen përmirësime, sikurse edhe në tekstet e gjuhës shqipe. Një risi do të ndodhë në librin e edukatës qytetare, ku në kurrikulën e lëndës do të përfshihet edhe kodi i sjelljes morale dhe antikorrupsioni.

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ministria, në mënyrë zyrtare, ka dërguar mbi 100 mijë tekste shkollore për të furnizuar nxënësit e Luginës së Preshevës, mirëpo këto libra u pamundësuan të dërgohen në destinacionin e duhur, duke qëndruar për 6 muaj në terminalin doganor. Përkundër marrëveshjes në Bruksel, Qeveria e Serbisë e pengoi hyrjen e teksteve shkollore për nxënësit shqiptarë të Luginës së Preshevës. Në këtë aspekt, Ministria e Arsimit ka vendosur masat e reciprocitetit, duke e angazhuar Inspektoratin e Arsimit për rishikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Ministria ka pranuar kërkesë për lejimin e hyrjes dhe përdorimit të librave për nevojat e nxënësve të komunitetit serb në Republikën e Kosovës, gjë që të njëjtën e ka zbatuar.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë ka dërguar libra shkollorë për komunitetin shqiptar në Mal të Zi dhe në Diasporë, sikurse edhe ka pranuar libra nga Bosnja dhe Hercegovina për nevojat e nxënësve të komunitetit boshnjak në Kosovë.

Në kuadër të kësaj, Ministria do të rishikojë mundësitë e botimit të librave shkollorë në formë elektronike, si dhe të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të udhëzimit administrativ, me qëllim të vendosjes së standardeve.

Alush Isotgu (MASHT), njoftoi Komisionin lidhur me mënyrën e organizimit dhe shpërndarjen e teksteve shkollore, e cila gjer më tani, është bërë nga katër shtëpi botuese, që janë: “Dukagjini”, “Libri Shkollor”, “Cambridge” dhe “Albas”. Ai foli për shumën e përgjithshme të buxhetit për

tekste shkollore për periudhën 2015-2016, që është 8.451.500, numrin e teksteve të botuara 4.245.270 , si dhe numrin e teksteve shkollore për diasporë dhe shumën buxhetore që është 21.000.

Ai tha se Ministria, në kuadër të angazhimeve, ka formuar një komision që do të bëjë vlerësimin e teksteve shkollore.

Nait Hasani, kryetar, tha se në të gjeturat nga raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin parauniversitar, vërehet se ka ndryshime në përmbajtjen e teksteve shkollore nga shtëpitë botuese të ndryshme për lëndët e njëjta. Më tej, theksoi se numri i teksteve shkollore të mbetura në stoqe gjatë vitit është i madh. Në këtë aspekt, përcaktimi i standardeve dhe numri i nxënësve do ta zvogëlonte shumën totale të shpenzimeve. Më tej, ai shtroi çështjen e librave të historisë të nxënësve të komunitetit serb, si tekste me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminuese.

Shpejtim Bulliqi, në diskutimin e tij tha se aktivizimi i Këshillit për tekste shkollore është i domosdoshëm, ngase si i tillë, përcakton standardet e vlerësimit të teksteve. Ai ngriti edhe çështjen e formës së përzgjedhjes dhe botimit të teksteve shkollore, ku theksoi tekstin e lëndës së gjeografisë, ku ekzistojnë të dhëna diametralisht të kundërta me gjendjen aktuale në vend. Me këtë rast, procesi i rishikimit dhe spastrimit të teksteve shkollore është i mirëseardhur. Përmendi çështjen e kthimit të teksteve shkollore, të destinuara për Luginën e Preshevës, duke thënë se ky vendim ishte i nxituar dhe kërkoi të gjendet mënyra sesi do të dërgohen këto tekste shkollore. Sa i përket pajisjes së nxënësve me tekste shkollore, me qëllim të reduktimit të shpenzimeve buxhetore, kërkoi të rishikohet udhëzimi administrativ, në mënyrë që shpërndarja e librave të bëhet çdo dy vite. Kërkoi nga ministri që të informojë opinion publik, në lidhje me furnizimin e nxënësve të komunitetit serb me libra nga Qeveria e Serbisë, dhe me këtë rast, të kërkohet reciprocitet.

Mufera Shinik, tha se sa i përket nxënësve të komunitetit turk, ekzistojnë tekste shkollore në disa lëndë, mirëpo në këtë aspekt mungojnë fletoret e punës së lëndëve përkatëse. Sa i përket mësimin të gjuhës shqipe nga nxënësit e komunitetit turk, tha se nuk ka mjete të mjaftueshme, për shkak të përdorimit joadekuat të librave të nxënësve nga klasa të ndryshme. Kërkoi nga ministri rishikimin e librave, të teksteve mësimore të lëndës së kimisë për komunitetin turk.

Sergjan Popoviç, pyeti ministrin: A ka në përbërjen e Këshillit për tekste shkollore anëtar të komunitetit serb dhe lidhur me tekstet shkollore për Luginën e Preshevës, a ekziston ndonjë marrëveshje me shkrim me Ministrinë e Arsimit të Serbisë?

Bekim Haxhiu, në diskutimin e tij u përqendrua në problematikën e peshës së çantave shkollore dhe propozoi që kjo çështje të zgjidhet me anë të kurrikulës apo botimi i teksteve të bëhet në dy pjesë semestrale, si dhe të shikohet për cilësinë e letrës në botim. Më tej, shtroi çështjen e transportit të nxënësve dhe kërkoi që të ndryshohet udhëzimi administrativ, që transporti të mos kufizohet në 4 km, për arsye se rrethanat e ndryshme ndikojnë në këtë aspekt, në mënyrë që gjatë udhëtimit të mos rrezikohet jeta e fëmijëve.

Lidhur me çështjet e ngritura, ministri theksoi se sa i përket standardeve, parashihen 13 standarde të parapara për vlerësimin e teksteve shkollore. Ai tha se duke filluar nga muaji mars, secili tekst që nuk i përmban këto standarde, do të ndërrohet. Sa i përket çështjes së ngritur nga deputeti

Popoviç, tha se kemi këshilltar, sa i përket testit të maturës, dhe gjatë bisedimeve në Bruksel, ka pasur pajtueshmëri për furnizim më tekste shkollore, duke i anashkaluar librat e historisë dhe të gjeografisë. Çështja e mbipeshës së çantave shkollore, ende nuk është zgjidhur. Pra, është një problem që kërkon rishikim të kurrikulave, ndërsa përkrahu shqyrtimin e idesë për ndarjen e botimit të librit në mënyrë semestrale.

1. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Kryetari i Komisionit propozoi që kjo pikë e rendit të ditës, të diskutohet në mbledhjen e ardhshme, ku do të ftohet ministri dhe do të diskutohet lidhur me rekomandimet e dala nga raporti i zbatimit të Ligjit parauniversitar në Kosovë.
Me këtë propozim u pajtua edhe ministri i Arsimit.

2. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani